		<b>ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS</b> <b>KOSOVO DOCTORS CHAMBER</b> <b>LEKARSKA KOMORA KOSOVA</b>	
Nr. Prot.:	<u>                    </u>	Nr. Prot.:	<u>03/2024</u>
Udh:	<u>                    </u>	Gr. Prot.:	<u>                    </u>
Jedritca:	<u>                    </u>		
Nr. i faqeve:	<u>                    </u>	Data:	<u>20.02.2024</u>
No. of pages:	<u>-39-</u>	Data:	<u>                    </u>
Br. stranica:	<u>                    </u>	Datum:	<u>                    </u>
<small>Prishtinë</small>			



**ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS**  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

**RREGULLORE**  
**PËR**  
**EDUKIMIN E VAZHDUESHËM PROFESIONAL**

Prishtinë,  
Shkurt 2024

**KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS (OMK)**, në mbështetje të Nenit 19, paragrafit 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 22, paragrafin 1 me nën-paragrafin 1.1 dhe në lidhje me Nenin 23 të Statutit të OMK-së, si dhe Nenin 23, paragrafin 2 të Rregullores për Procedurat Vendimmarrëse të Organeve të OMK, e miratuar në mbledhjen e datës 19 qershor 2018, e plotësuar dhe ndryshuar në mbledhjen e rregullt të datës 15 shkurt 2023, Kuvendi i OMK-së miraton këtë:

**RREGULLORE  
PËR  
EDUKIMIN E VAZH DUESHËM PROFESIONAL**

(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 02/2024 të Kuvendit të OMK-së, të datës 20 shkurt 2024).

**KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, procedurat e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (në vazhdim EVP), akreditimi i planprogrameve të EVP-së, si dhe përkrahja financiare e shoqatave profesionale që organizojnë aktivitete të EVP-së.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Kjo rregullore zbatohet ekskluzivisht për mbikëqyrjen, vlerësimin dhe përkrahjen e aktiviteteve të EVP-së. Gjithashtu, procedurat e veçanta të parapara me këtë rregullore do të jenë të zbatueshme në procesin e rilicencimit të mjekëve.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Termet dhe akronimet e përdorura në tekstin e kësaj rregulloreje, në zbatim të kësaj rregulloreje kanë këto kuptime:
  - 1.1 **EVP**- nënkupton Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
  - 1.2 **Aktivitetet e EVP-së** - nënkupton ngjarjet e organizuara nga institucionet shëndetësore apo shoqatat profesionale që kanë karakter profesional dhe që organizohen me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të mjekëve;
  - 1.3 **Pikët kredituese** - nënkupton sistemin e vlerësimit të ngjarjeve që ndiqen nga profesionistët mjekësor për qëllime të edukimit të vazhdueshëm profesional;
  - 1.4 **Oda** - nënkupton Odën e Mjekëve të Kosovës;

**1.5 Komisioni për EVP** - nënkupton organin kompetent të Odës i cili zbaton, mbikëqyrë, planifikon dhe vlerëson aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional.

2. Termet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

#### **Neni 4**

##### **Përbërja dhe funksionimi i Komisionit për EVP**

1. Komisioni për EVP është organi i Odës, i cili në mënyrë ekskluzive zbaton kompetencën publike të EVP-së.
2. Komisioni për EVP përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve që janë të zgjedhur nga Kuvendi i Odës, në përputhje me dispozitat e Statutit të Odës dhe akteve normative të Odës.
3. Puna dhe procedurat e vendimmarrjes së Komisionit të EVP-së janë të rregulluara me Rregulloren për Procedurat e Vendimmarrjes të Organeve të Odës.

#### **Neni 5**

##### **Ushtimi i kompetencës së EVP-së**

1. Mbikëqyrjen dhe aranzhimin administrativ të EVP-së, në cilësi të kompetencës publike, e ushtron Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (EVP), si komision i përhershëm i Odës.
2. Komisioni për EVP në ushtrim të këtij funksioni publik, do të ketë këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - 2.1 Zbatimi i procedurave të veçanta administrative për evidentimin e EVP-së;
  - 2.2 Krijimi i kushteve dhe stimulimi i sponsorizimit të aktiviteteve të EVP-së;
  - 2.3 Zbatimi i buxhetit të Odës për përkrahjen e organizimit të aktiviteteve të EVP-së nga institucionet shëndetësore dhe shoqatat profesionale mjekësore;
  - 2.4 Akreditimi i aktiviteteve të EVP-së;
  - 2.5 Akreditimi i planeve vjetore dhe programeve për EVP;
  - 2.6 Akreditimin e pikëve të fituara nga anëtarët e Odës në angazhimin e tyre në procesin e EVP-së për nevojat e rilicencimit;
  - 2.7 Menaxhimin e regjistrit të aktiviteteve të EVP-së;
  - 2.8 Në bashkëpunim me Komisionin për Licencim, përcjellë evidencën e profileve profesionale të anëtarëve të Odës në procesin e EVP-së; dhe
  - 2.9 Kryen edhe funksione të tjera sipas nevojave për plotësimin e qëllimit të kompetencës publike për EVP, të bazuar në legjislacionin në fuqi dhe akte të brendshme normative të Odës.
3. Komisioni për EVP bashkëpunon dhe kontakton në mënyrë të vazhdueshme me organet e tjera të Odës, në veçanti me Këshillin Drejtues, për çështjet që janë në interes të përgjithshëm të Odës.

## Neni 6 Definicionet mbi aktivitetet e EVP-së

1. Me qëllim të unifikimit të terminologjisë së aktiviteteve të EVP-së dhe zbatimit të kësaj rregulloreje, me dispozita të këtij neni disa nga termet kanë këtë kuptim:

**1.1.1 Kongresi/konferenca vendore kombëtare** - e cila mund të organizohet nga shoqatat profesionale dhe shkencore kosovare, ndonjë institucion tjetër përkatës kosovar (p.sh. Akademia, Fakulteti i Mjekësisë, entet shëndetësore, trupat e ndryshme shtetërore që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe shkencën), respektivisht personat e ndryshëm fizik dhe juridik. Në kongreset/konferencat vendore, **marrin pjesë vetëm pjesëmarrës vendor.**

1. **1.2 Kongresi/konferenca vendore me pjesëmarrje ndërkombëtare** - mund të organizohet nga shoqatat profesionale dhe shkencore kosovare, ndonjë institucion tjetër përkatës kosovar (p.sh. Akademia, Fakulteti i Mjekësisë, entet shëndetësore, trupat e ndryshme shtetërore që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe shkencën), respektivisht personat e ndryshëm fizik dhe juridik. Në kongreset/konferencat vendore me pjesëmarrje ndërkombëtare, duhet që të marrin pjesë patjetër **së paku tre ekspert aktiv të jashtëm.**

- 1.1.3 Kongresi/konferenca ndërkombëtare** - mund të organizohet nga shoqatat profesionale dhe shkencore kosovare dhe/ose ndërkombëtare, ndonjë institucion tjetër përkatës kosovar (p.sh. Akademia, Fakulteti i Mjekësisë, entet shëndetësore, trupat e ndryshme shtetërore që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe shkencën), respektivisht personat e ndryshëm fizik dhe juridik. Në kongresin/konferencën ndërkombëtare marrin pjesë ekspertë vendor dhe ndërkombëtar. Së paku 1/3 e pjesëmarrësve aktiv duhet të jenë ekspertë të jashtëm.

**1.2.1 Simpoziumi vendor-kombëtar** - mund të organizohet nga shoqatat profesionale dhe shkencore kosovare, ndonjë institucion tjetër përkatës kosovar (p.sh. Akademia, Fakulteti i Mjekësisë, entet shëndetësore, trupat e ndryshme shtetërore që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe shkencën), respektivisht personat e ndryshëm fizik dhe juridik. Në Simpoziumin vendor **pjesëmarrësit aktiv janë vendor.**

- 1.2.2 Simpoziumi vendor me pjesëmarrje ndërkombëtare** - mund të organizohet nga shoqatat profesionale dhe shkencore kosovare, ndonjë institucion tjetër përkatës kosovar (p.sh. Akademia, Fakulteti i Mjekësisë, entet shëndetësore, trupat e ndryshme shtetërore që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe shkencën), respektivisht personat e ndryshëm fizik dhe juridik. Në Simpoziumin vendor me pjesëmarrje ndërkombëtare duhet që së paku një pjesëmarrës aktiv të jetë ekspert ndërkombëtar.

**1.2.3 Simpoziumi ndërkombëtar** - mund të organizohet nga shoqatat profesionale dhe shkencore kosovare dhe ndërkombëtare, ndonjë institucion tjetër përkatës kosovar (p.sh. Akademia, Fakulteti i Mjekësisë, entet shëndetësore, trupat e ndryshme shtetërore që kanë të bëjnë me shëndetësinë dhe shkencën), respektivisht personat e ndryshëm fizik dhe juridik. Në simpoziumin ndërkombëtar, **1/3 e pjesëmarrësve aktiv duhet të jenë ekspertë të jashtëm/ndërkombëtar, dhe duhet të ketë së paku një anëtar të Këshillit Shkencor-profesional të jashtëm.**

**1.3 Workshop/Punëtori (Kurs pune, kurs demonstrativ, kurs teorik)** - paraqet një formë të përvetësimit të njohurive, aftësive të reja përmes ligjëratave teorike - praktike në grupe të vogla (deri në 50 pjesëmarrës). Pjesëmarrësit e kryejnë pjesën praktike të kursit në pacientë, fantom ose model nën mbikëqyrjen e mentorit të tyre.

**1.4 Kurset e edukimit të vazhdueshëm profesional-mjekësor** - paraqesin një edukim të organizuar nga lëmia e biomjekësisë dhe/ose shëndetësisë. Këto kurse sipas vlerës ndahen në tri kategoritë si në vijim:

**1.4.1 Në Kursin e kategorisë së parë (I)** - trajtohet dhe prezantohet në mënyrë bashkëkohore ndonjë problem aktual, më të rejat nga literatura botërore, kurse ligjëruesit duhet të jenë ekspertë të njohur nga lëmia përkatëse. Kursi i kategorisë së parë, duhet të ketë material të shkruar in extensor. Material i shkruar konsiderohen edhe materialet në formë elektronike (shembuj, skema konkretizuese diagnostike dhe terapeutike dhe/ose procedura rehabilituese dhe të ngjashme). Kohëzgjatja e kursit të kategorisë së parë, nuk guxon që të jetë **më e shkurtër se 15 orë të plota (900 minuta)**. Këto kurse duhet të përfundojnë me provim me gojë, praktik ose të shkruar. Provimi me shkrim duhet të ketë së paku 30 pyetje. Pjesëmarrësi mund të sigurojë pikët nëse ka kaluar provimin me gojë ose praktik apo nëse ka plotësuar korrekt së paku 60% të pyetjeve të testit.

**1.4.2 Në Kursin e kategorisë së dytë (II)** - trajtohet dhe prezantohet në mënyrë bashkëkohore ndonjë temë e caktuar, më të rejat nga literatura botërore, kurse ligjëruesit duhet të jenë ekspertë të njohur nga lëmia përkatëse. Kursi i kategorisë së dytë, duhet të ketë material të shkruar in extensor. Material i shkruar konsiderohen edhe materialet në formë elektronike (shembull: skema konkretizuese diagnostike dhe terapeutike dhe/ose procedura rehabilituese dhe të ngjashme). Kohëzgjatja e kursit të kategorisë së dytë nuk guxon të jetë më e shkurtër se **7 orë të plota (420 minuta)**. Në këtë kategori të kursit, **provimi nuk është obligativ**.

**1.4.3 Në Kursin e kategorisë së tretë (III)** - trajtohet dhe prezantohet në mënyrë bashkëkohore ndonjë temë e caktuar, më të rejat nga literatura botërore, kurse ligjëruesit duhet të jenë ekspertë të njohur nga lëmia përkatëse. Kursi i kategorisë së tretë, duhet të ketë material të shkruar. Material i shkruar konsiderohen të gjitha materialet në formë elektronike (shembull: skema konkretizuese diagnostike dhe terapeutike dhe/ose procedura rehabilituese dhe të ngjashme). Kohëzgjatja e kursit të kategorisë së tretë nuk guxon të jetë më e shkurtër se 4 orë të plota (240 minuta). Në këtë kategori të kursit, **provimi nuk është obligativ**.

#### ***Kurset ndërkombëtare***

**1.4.4 Kursi ndërkombëtar i kategorisë së parë (I)** - trajtohet dhe prezantohet në mënyrë bashkëkohore ndonjë temë e caktuar, më të rejat nga literatura botërore, kurse ligjëruesit duhet të jenë ekspertë të njohur nga lëmia përkatëse. Kursi ndërkombëtar i kategorisë së parë duhet të ketë material të shkruar in extenso. Material i shkruar konsiderohen të gjitha materialet në formë elektronike (shembull: skema konkretizuese diagnostike dhe terapeutike dhe/ose procedura rehabilituese dhe të ngjashme). Kursi ndërkombëtar i kategorisë së parë patjetër duhet të ketë 1/3 e pjesëmarrësve aktiv të jashtëm. Kohëzgjatja e kursit të kategorisë së parë, nuk guxon të jetë më e shkurtër se **20 orë të plota (1200 minuta)**. Këto kurse duhet të përfundojnë me provim me gojë, praktik ose të shkruar. Provimi me shkrim duhet të ketë së paku 30 pyetje. Pjesëmarrësi mund të sigurojë pikët nëse ka kaluar provimin me gojë ose praktik apo ka plotësuar korrekt së paku 60% të pyetjeve të testit.

**1.4.5 Kursi ndërkombëtar i kategorisë së dytë (II)** - trajtohet dhe prezantohet në mënyrë bashkëkohore ndonjë temë e caktuar më të rejat nga literatura botërore, kurse ligjëruesit duhet të jenë ekspertë të njohur nga lëmia përkatëse. Kursi ndërkombëtar i kategorisë së dytë, duhet të ketë material të shkruar in extenso. Material i shkruar konsiderohen të gjitha materialet në formë elektronike (shembull: skema konkretizuese diagnostike dhe terapeutike dhe/ose

procedura rehabilituese dhe të ngjashme). Kursi ndërkombëtar i kategorisë së dytë, patjetër duhet të ketë 1/3 e pjesëmarrësve aktiv të jashtëm. Kohëzgjatja e kursit të kategorisë së dytë nuk guxon të jetë më e shkurtër se 10 orë të plota (600 minuta).

**1.4.6 Kursi ndërkombëtar i kategorisë së tretë (III)** - trajtohet dhe prezantohet në mënyrë bashkëkohore ndonjë temë e caktuar, më të reja nga literatura botërore, kurse ligjëruesit duhet të jenë ekspertë të njohur nga lëmia përkatëse. Kursi ndërkombëtar i kategorisë së tretë duhet të ketë material të shkruar. Material i shkruar konsiderohen edhe materialet në formë elektronike (shembull: skema konkretizuese diagnostike dhe terapeutike dhe/ose procedura rehabilituese dhe të ngjashme). Kursi ndërkombëtar i kategorisë së tretë patjetër duhet të ketë 1/3 e pjesëmarrësve aktiv të jashtëm. Kohëzgjatja e kursit të kategorisë së tretë nuk guxon të jetë më e shkurtër se 7 orë të plota (420 minuta). Provimi nuk është obligativ.

**1.5 Edukimi i ngushtë dhe specifik nga ndonjë lëmi biomjekësore dhe/ose shëndetësore** - paraqet një edukim gjatë të cilit pjesëmarrësit arrijnë njohuri dhe shkathtësi nga lëmia e caktuar (p.sh. diagnostika specifike dhe ndërhyrjet në ndonjë degë të caktuar specialistike). Edukimi i ngushtë/specifik mund të ketë tri shkallë-kategori si në vijim:

**1.5.1 Edukimi i ngushtë specifik i shkallës së parë (I)** - pjesëmarrësit arrijnë njohuri dhe shkathtësi nga lëmia e caktuar (p.sh. diagnostika specifike dhe ndërhyrjet në ndonjë degë të caktuar specialistike) me të dhënat më të reja nga literatura botërore. Ligjëruesit duhet të jenë ekspertë të pranuar nga lëmia përkatëse. Edukimi i ngushtë specifik duhet të ketë material të shkruar in extenso. Material i shkruar konsiderohen të gjitha materialet në formë elektronike (shembuj, skema konkretizuese diagnostike dhe terapeutike dhe/ose procedura rehabilituese dhe të ngjashme). Kohëzgjatja e edukimit të ngushtë-specifik të shkallës së parë nuk guxon të jetë më e shkurtër se 60 orë të plota (3600 minuta). Këto kurse duhet të përfundojnë me provim përkatës teorik dhe praktik.

**1.5.2 Edukimi i ngushtë specifik i shkallës së dytë (II)** - pjesëmarrësit arrijnë njohuri dhe shkathtësi nga lëmia e caktuar (p.sh. diagnostika specifike dhe ndërhyrjet në ndonjë degë të caktuar specialistike) me të dhënat më të reja nga literatura botërore. Ligjëruesit duhet të jenë ekspertë të pranuar nga lëmia përkatëse. Edukimi i ngushtë specifik duhet të ketë material të shkruar. Material i shkruar konsiderohen edhe materialet në formë elektronike (shembull: skema konkretizuese diagnostike dhe terapeutike dhe/ose procedura rehabilituese dhe të ngjashme). Kohëzgjatja e edukimit të ngushtë specifik të shkallës së dytë, nuk guxon që të jetë më e shkurtër se 40 orë të plota (2400 minuta). Këto kurse duhet të përfundojnë me provim përkatës teorik dhe praktik.

**1.5.3 Edukimi i ngushtë specifik i shkallës së tretë (III)** - pjesëmarrësit arrijnë njohuri dhe shkathtësi nga lëmia e caktuar (p.sh. diagnostika specifike dhe ndërhyrjet në ndonjë degë të caktuar specialistike) me të dhënat më të reja nga literatura botërore. Ligjëruesit duhet të jenë ekspertë të pranuar nga lëmia përkatëse. Edukimi i ngushtë specifik duhet të ketë material të shkruar. Material i shkruar konsiderohen edhe materialet në formë elektronike (shembull: skema konkretizuese diagnostike dhe terapeutike dhe/ose procedura rehabilituese dhe të ngjashme). Kohëzgjatja e edukimit të ngushtë specifik të shkallës së tretë, nuk guxon të jetë më e shkurtër se 25 orë të plota (1500 minuta). Këto kurse duhet të përfundojnë me një vlerësim përkatës mbi arritjen e njohurive dhe shkathtësive.

**1.5.4 Seminar dhe takimi profesional**

- 2.1 Komisioni me rastin e vlerësimit të aktiviteteve të EVP-së do të shqyrtojë edhe certifikatat e fituara në bazë të programeve dhe trajnimeve të ndjekura në internet, i ashtuquajturit edukimi në distancë. Kusht për t'u vlerësuar programi i tillë i EVP-së është që ai të jetë kredibil dhe të jetë i akredituar nga vendi amë nga ku ofrohet ndjekja e tij.

## Neni 7

### Aktivitetet akademike dhe shkencore në kuadër të EVP-së

1. Mjekët gjatë formësimit të tyre profesional marrin pjesë në kurrikulat akademike dhe profesionale me qëllim të ngritjes së njohurive shkencore dhe profesionale.
2. Aktivitetet e tilla, përfshijnë por nuk kufizohen në:
  - 2.1 Edukimin specialistik/subspecialistik;
  - 2.2 Studimet e doktoratës;
  - 2.3 Studimet pasdiplomike në programin master;
  - 2.4 Studimet profesionale dhe shkencore;
  - 2.5 Kurset për aftësim profesional (ligjërata);
  - 2.6 Qëndrimi studimor aktiv jashtë shtetit;
  - 2.7 Publikimi i punimeve në revistat profesionale dhe shkencore;
  - 2.8 Publikimi i librave dhe doracakëve nga mjekësia dhe format tjera; dhe
  - 2.9 Takimet dhe format tjera nga Plani vjetor i programit të aftësimit profesional.
3. Aktivitetet nga paragrafi 2 i këtij neni paraqesin po ashtu aktivitete në kuadër të EVP-së, që vlerësohen nga Komisioni për EVP gjatë shqyrtimit të lëndëve të parashtruara.

## KAPITULLI II - AKREDITIMI I PLANEVE DHE AKTIVITETEVE

### Neni 8

#### Subjektet e autorizuara për akreditim të planeve vjetore, programeve dhe aktiviteteve të EVP-së

1. Në cilësinë e subjekteve të autorizuara për procesin e akreditimit të planeve vjetore, programeve dhe aktiviteteve të EVP-së, janë:
  - 1.1 Institucionet shëndetësore të tri niveleve të kujdesit shëndetësor;
  - 1.2 Shoqatat Profesionale të Mjekëve;
  - 1.3 Institucionet e arsimit të lartë të akredituara nga organi kompetent i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
  - 1.4 Subjektet biznesore që kanë veprimtarinë e regjistruar të ndërlidhur me fushën e mjekësisë; dhe

- 1.5 Personat e tjerë fizik dhe juridik me kusht që të jenë të licencuar për aftësim profesional.
2. Oda është po ashtu subjekt i autorizuar që bartë aftësi juridike për të organizuar aktivitete për EVP.
  3. Të paktën 1 (një) herë në vit, Oda do të organizojë aktivitetet për qëllime të EVP-së. Me këtë rast Oda mund të organizojë aktivitetin e tillë në bashkëpunim me ndonjërin nga subjektet e autorizuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, në përjashtim me organizata fitimprurëse.
  4. Pjesëmarrja në aktivitete që janë të organizuara nga Oda mund të kufizohet në pjesëmarrjen vetëm të anëtarësisë së Odës.

### **Neni 9**

#### **Akreditimi i planeve vjetore dhe programeve të EVP**

1. Institucionet shëndetësore dhe shoqatat profesionale janë të obliguara të përgatisin planet vjetore dhe programet e EVP që do të organizohen në bazë vjetore.
2. Plani vjetor dhe programi për EVP duhet të përgatitet nga subjekti i cili parashtron aplikacionin për akreditim të planit vjetor apo programit, duke detajuar përmbajtjen e aktiviteteve, qëllimin dhe dobinë profesionale të aktivitetit për pjesëmarrësit dhe institucionin.
3. Plani dhe programi i EVP-së krahas të dhënave që janë përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni, ndër të tjera duhet të përmbajë:
  - 3.1 Vendin dhe kohën e ngjarjeve;
  - 3.2 Temën dhe ligjëruesit në ngjarje; dhe
  - 3.3 Mënyrën e ligjërimit (Fizike/Online/Hibride).

### **Neni 10**

#### **Procedura e akreditimit të planit vjetor dhe programit të EVP-së**

1. Procedura për akreditimin e planit vjetor dhe programit të EVP iniciohet me dorëzimin e aplikacionit që i është bashkëngjitur Shtojcës I (Formulari nr. 2 dhe formulari nr. 4), i cili plotësohet nga personi i autorizuar i subjektit i cili e parashtron aplikacionin për akreditim.
2. Aplikacioni për akreditim të planit vjetor dhe programit të EVP duhet parashtruar nga ana e subjekteve të interesuara jo më vonë se data 01 dhjetor për vitin pasues.
3. Komisioni për EVP shqyrton aplikacionin me dokumentacionin përkatës dhe në rast të akreditimit lëshon certifikatë me të cilën akreditohet plani vjetor apo programi i EVP-së.



4. Në rast të refuzimit të akreditimit të planit vjetor apo programit, subjektet e interesuara kanë të drejtë të paraqesin ankesë pranë Këshillit Drejtues të Odës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të vendimit me të cilin është refuzuar akreditimi i planit vjetor dhe programit.
5. Ndryshimet në përmbajtjen e planit vjetor apo programit të akredituar, duhet të parashtrihen për akreditim pranë Komisionit për EVP së paku pesë (5) ditë pune para mbajtjes së ligjëratës, në të kundërt ligjëratat e mbajtur do të konsiderohet e paakredituar nga Komisioni.

### **Neni 11** **Akreditimi i aktiviteteve të EVP**

1. Subjektet e autorizuar mund të parashtrijnë kërkesë për akreditim të aktivitetit të EVP-së pranë Komisionit për EVP.
2. Për akreditim të aktivitetit, subjekti i autorizuar duhet të parashtrijë pranë Komisionit për EVP aplikacionin e veçantë që gjendet në Shtojcën I të kësaj rregulloreje.
3. Subjekti i autorizuar krahas aplikacionit, duhet të bashkëngjës dokumentacionin sipas Nenit 12 të kësaj rregulloreje, si dhe përshkrimin e detajuar të aktivitetit.
4. Afati për parashtrimin e aplikacionit për akreditim të aktivitetit është së paku 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para mbajtjes së aktivitetit.
5. Komisioni për EVP me rastin e akreditimit të aktivitetit do të lëshojë certifikatë akredituese në të cilën do të vlerësojë llojin e aktivitetit dhe pikët kredituese.
6. Organizatori obligohet që pikët kredituese me të cilat akreditohet aktiviteti t'i shpërndajë pjesëmarrësve si në vijim:
  - 6.1 shpërndarja totale e pikëve - në rast se aplikuesi qëndron gjatë gjithë kohës kur zhvillohet aktiviteti;
  - 6.2 shpërndarja 50% e pikëve - në rast se aplikuesi qëndron gjysmën e kohës kur zhvillohet aktiviteti;
  - 6.3 shpërndarja e 1/3 e pikëve - në rast se aplikuesi qëndron më pak se gjysma e kohës kur zhvillohet aktiviteti.
7. Prezenca e mjekëve në aktivitete do të përcillet me skenimin e barkodit të regjistrimit përmes aparateve të Odës të cilat obligohet organizatori t'i përdor ditën e ngjarjes (sipas shtojcës IV). Huazimi i aparateve për përcjelljen e aktiviteteve do të rregullohet përmes deklaratës në shtojcën IV të kësaj Rregulloreje. Evidentimi i ndjekjes duhet të bëhet për çdo sesion.
8. Përjashtim nga pika 6 dhe 7 bëjnë organizatorët e institucioneve shëndetësore në planet vjetore, ku mjafton dëshmia e evidencës me shkrim për pjesëmarrësit në aktivitet.

9. Organizatori i aktivitetit është i obliguar që me rastin e përfundimit të aktivitetit t'u lëshojë certifikata pjesëmarrësve. Në certifikatë domosdoshmërisht duhet të vihet logo e Odës, autoriteti i cili e ka akredituar ngjarjen, numrin e referencës së akreditimit të aktivitetit nga Oda, pikët kredituese dhe data e organizimit të ngjarjes sipas paragrafit 5 të këtij neni.
10. Subjekti të cilit i lëshohet certifikata e akreditimit të aktivitetit është i obliguar që të paguajë taksën administrative për akreditim të aktivitetit sipas lartësisë së përcaktuar me vendim të organit kompetent.
11. Afati për tërheqjen e certifikatës dhe pagesës së taksës administrative për akreditim program/aktivitet është 8 ditë, nga dita e njoftimit për vendimin e marrë nga Komisioni për EVP, përmes zyrtarit administrativ pranë Komisionit.
12. Pas përfundimit të aktivitetit, organizatori obligohet të sjellë raportin lidhur me aktivitetin e mbajtur së bashku me listën e ligjëruesve dhe pjesëmarrësve si dhe formën e certifikatës e cila do të lëshohet për ligjëruesit dhe pjesëmarrësit, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e mbajtjes së aktivitetit. Pas aprovimit të raportit dhe formës së certifikatës nga Komisioni për EVP, organizatori duhet t'i sjellë certifikatat për nënshkrim në zyrat e Odës, sipas listës së pjesëmarrësve dhe të njëjtat t'i tërheqë jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e dorëzimit. Në të kundërtën, çdo certifikatë jashtë këtij afati nuk do të pranohet dhe nënshkruhet nga KEVP.
13. Në rastin e aplikimit të sistemit elektronik në organizimin e aktivitetit, organizatori nuk obligohet t'i sjellë certifikatat për nënshkrim nga pika 13.
14. Organizatori i aktivitetit të akredituar i cili nuk përmban kuotizim, nuk ka të drejtë të lëshojë certifikatat e aktivitetit me pagesë për pjesëmarrësit.

## **Neni 12**

### **Dokumentet e nevojshme për akreditimin e planeve vjetore, programit dhe aktiviteteve të tjera të EVP-së**

1. Aplikuesit për akreditim të aktiviteteve të EVP-së, krahas aplikacionit të dorëzuar, janë të obliguar që aplikacionit t'i bashkëngjeshin dokumentet si në vijim:
  - 1.1 Programin e hollësishëm të aktivitetit duke përfshirë përcaktimin e objektivave, përmbajtjes, metodologjisë, orarit dhe vendit të mbajtjes;
  - 1.2 Certifikatën e regjistrimit të biznesit ose OJQ (për shoqatat, subjektet biznesore të ndërlidhura me fushën e mjekësisë);
  - 1.3 Certifikatën e numrit fiskal (për shoqatat, subjektet biznesore të ndërlidhura me fushën e mjekësisë);

- 1.4 CV e ligjëruesit me të cilën dëshmohet se ligjëruesi i ftuar është nga lëmia përkatëse;
- 1.5 Në rastet e organizimit të kongreseve, konferencave dhe simpoziumeve, aplikuesit duhet të parashtrajnë raportin e këshillit shkencor mbi punimet e pranuar të cilat do të prezantohen në eventin e tillë;
- 1.6 Aplikuesi nuk ka të drejtë të ndryshojë programin e aktivitetit të akredituar nga KEVP, pa njoftimin dhe miratimin paraprak të KEVP.

2. Dështimi për të plotësuar dokumentacionin e përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, paraqet bazë për refuzimin e akreditimit të planit vjetor dhe programit të EVP-së.
3. Përjashtim nga nënparagrafi 1.4 i pikës 2 bëjnë vetëm ligjëruesit brenda institucionit shëndetësor për planet vjetore dhe programet e EVP-së.

### **Neni 13**

#### **Mbikëqyrja e aktiviteteve dhe programeve**

1. Komisioni për EVP do të mbikëqyrë zbatimin e planit vjetor, aktiviteteve dhe programeve të cilat janë akredituar nga Oda, përmes raporteve të dërguara nga organizatori.
2. Në rast se subjekti i cili zbaton planin vjetor dhe programin e akredituar nuk i përmbahet përshkrimeve për të cilat është lëshuar certifikata për akreditim, Komisioni do të revokojë certifikatën dhe aktivitetet e mbetura konsiderohen si të paakredituara.
3. Komisioni me rastin e revokimit të certifikatës, subjektit mund t'i shqiptojë masë ndaluese me ndalim të akreditimit nga 1 deri në 3 vite të ardhshme.
4. Revokimi i certifikatës do të evidentohet në Regjistrin e aktiviteteve të EVP-së.
5. Aktivitetet e vijura deri në revokim të certifikatës do të konsiderohen si të akredituara.
6. Subjekti, aktiviteti i të cilit është akredituar, obligohet që në afat prej dy (2) javë nga mbajtja e aktivitetit të dorëzojë raportin e mbarëvajtjes së aktivitetit, programin e realizuar, listën e pjesëmarrësve, raportin e organizatorit dhe raportin financiar në rast të përfitimit të përkrahjes financiare nga Oda.
7. Komisioni i EVP-së rezervon të drejtën për rishqyrtimin e aktivitetit të akredituar sipas kërkesës së aplikuesit dhe në rast të konstatimit të ndryshimit të programit të aktivitetit dhe pikëve akredituese, të revokojë akreditimin e aktivitetit.
8. Komisioni i EVP-së, në rast të revokimit të aktivitetit sipas pikës 7, në rast të përkrahjes financiare, organizatori i aktivitetit obligohet që t'i kthejë mjetet e dhëna nga OMK si përkrahje për organizimin e aktivitetit, në afat kohor deri në 14 ditë nga dita e revokimit të aktivitetit.

#### Neni 14

### Gjobat ndëshkuese në rast të mosrespektimit të organizimit të aktiviteteve

1. Në rastet kur subjektet të cilat përmbajnë kuotizim gjatë zbatimit të aktivitetit dhe programit të akredituar të EVP-së nuk i respektojnë kriteret e përcaktuara me këtë Rregullore, Komisioni do të shqiptojë sanksionin administrativ në shumë prej 100% të taksës së paguar me rastin e akreditimit të aktivitetit dhe me mosakreditim të aktiviteteve për organizatorin prej 1 vit nga data e shkeljes së kriterëve.
2. Ndaj vendimit me të cilin Komisioni shqipton sanksionin administrativ, palët e pakënaqura mund të parashtrajnë ankesë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të vendimit nga ana e palës. Ankesa e tillë parashtrohet pranë Këshillit Drejtues të Odës.

## KAPITULLI III - AFTËSIMI PROFESIONAL

#### Neni 15

### Obligimi i mjekëve për edukim të vazhdueshëm profesional

1. Anëtari i Odës, respektivisht mjeku, është i obliguar që t'i nënshtrohet edukimit të vazhdueshëm profesional në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e kujdesit mjekësor dhe të plotësojë kushtet për rilicencim.
2. Në rastet kur kërkohet rilicencim në lëminë tjetër specialistike, jashtë fushës së specializimit aktual, aplikuesi obligohet të grumbullojë 100 pikë për rilicencim nga aktivitetet e EVP-së.
3. Mjeku i cili është në specializim llogaritet të ketë grumbulluar vetëm 50% të pikëve, pjesën tjetër të pikëve obligohet t'i grumbullojë përmes aktiviteteve të EVP-së.
4. Çdo ndërprerje e edukimit specialistik dhe EVP-së me arsye të dëshmuar si pushimi i lehonisë, sëmundje të ndryshme si dhe arsye të tjera lirohen nga obligimi i grumbullimit të pikëve për periudhë kohore deri në një (1) vit. Për periudhën 6 mujore lirohen për 10 pikë, ndërsa për periudhën një (1) vjeçare lirohen për 20 pikë.
5. Aplikantët që i takojnë kategorive sipas paragrafit 4 të këtij neni, obligohen që të dorëzojnë pranë Komisionit për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional - OMK, kërkesën për lirim nga grumbullimi i pikëve së bashku me dokumentacionin i cili dëshmon arsyeshmërinë e pamundësisë së grumbullimit të pikëve që ka qëllim edukimin e vazhdueshëm profesional.
6. Të gjithë aplikantët të cilët pas shqyrtimit të lëndës për grumbullimin e 100 pikëshit me qëllim të rilicencimit kanë arritur të grumbullojnë së paku 95 pikë, në afat prej pesë (5) ditësh mund të paraqesin kërkesë pranë Komisionit me arsyeshmërinë e mungesës së pikëve, që rezulton me rishqyrtimin e vendimit të Komisionit të EVP-së.

7. Mjekët anëtarë të cilët nuk kanë arritur të grumbullojnë pikët kredituese i nënshtrohen provimit të rilicencimit sipas kriterëve të organit gjegjës të Odës, respektivisht Komisionit për Regjistrim, Licencim dhe Rilicencim - OMK.

#### **Neni 16** **Portofoli personal i EVP-së**

1. Anëtar i Odës është i obliguar që brenda 5 (pesë) viteve të grumbullojë në total 100 (njëqind) pikë për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së.
2. Të gjitha aktivitetet vendore të pa akredituara nga OMK nuk merren parasysh nga Komisioni për EVP.
3. Valorizimi i pikëve kredituese është kompetencë ekskluzive e Komisionit për EVP. Valorizimi i pikëve për pjesëmarrje të aktiviteteve do të bëhet sipas Shtojcës II, në të cilën janë përcaktuar pikët kredituese për secilin lloj të aktivitetit.
4. Me rastin e valorizimit të pikëve, Komisioni për EVP lëshon certifikatë në të cilën konstaton valorizimin e pikëve nga aktiviteti.
5. Pala e pakënaqur me valorizimin e bërë nga Komisioni për EVP, ka të drejtë ankese pranë Këshillit Drejtues në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të certifikatës për valorizim.

#### **Neni 17** **Mënyra e llogaritjes së pikëve**

1. Anëtar i Odës është i obliguar që të marrë pjesë në aktivitete të edukimit profesional në mënyrë që për 5 (pesë) vite të sigurojë 100 pikë kredituese të cilat duhet të shpërndahen në minimum 10 pikë kredituese për vit kalendarik.

#### **Neni 18** **Inicimi i procedurës**

1. Anëtar i Odës e inicion procedurën e valorizimit të portofolit personal përmes parashtrimit të aplikacionit që është përcaktuar në Shtojcën I (Formulari nr. 3) të kësaj rregulloreje.
2. Aplikacionit të plotësuar me të dhënat relevante dhe deklaratës nën betim duhet t'i bashkëngjiten edhe dokumentacionet përcjellëse, siç janë:
  - 2.1 Kopja e letërnjoftimit;
  - 2.2 Kopja e provimit specialistik, në rast se aplikuesi ka status profesional të tillë;
  - 2.3 Kopjet e certifikatave të aktiviteteve që ka marrë pjesë, dhe materiali tjetër që dëshmon aktivitetin e tij profesional dhe shkencor i cili mund të jetë objekt i vlerësimit.
  - 2.4 Për certifikatat e prezantuara nga aktivitetet edukuese të cilat nuk përmbajnë pikë akredituese në certifikatë, obligohet aplikuesi që së bashku me certifikatat të sjellë edhe

programin e aktivitetit përkatës si dhe çdo dëshmi tjetër e cila ofron të dhëna shtesë lidhur me certifikatën e aktivitetit të fituar nga aplikuesi.

3. Aplikuesi me rastin e dorëzimit të aplikacionit me dokumentacionin përcjellës, duhet të paguajë taksën administrative për inicim të procedurës pranë Komisioni për EVP.
4. Aplikacioni përcillet te Komisioni i EVP-së vetëm me dorëzimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara me rregullore për akreditim.
5. Aplikacionet e pa kompletuara nuk pranohen nga Shërbimi Profesional, përjashtimisht certifikatave të aktiviteteve të EVP.

## **KAPITULLI IV - SUBVENCIONIMET E VEÇANTA TË EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL**

### **Neni 19**

#### **Subvencionet e veçanta**

1. Me qëllim të përkrahjes së zgjerimit dhe avansimit të edukimit të vazhdueshëm profesional dhe me qëllim të ngritjes kadrovike të anëtarësisë së OMK-së dhe përpjekjes për ndikim të drejtpërdrejtë përmes zhvillimit të njohurive profesionale në sektorin e shëndetësisë, OMK do të subvencionojë aktivitete, organizime dhe edukimin profesional në aspektin individual duke mbështetur nga aspekti financiar këto segmente të edukimit të vazhdueshëm profesional si në vijim:
  - 1.1 Mbështetja e veçantë financiare e aktiviteteve/organizimeve të EVP-së sipas procedurës së konkurimit të shoqatave profesionale dhe institucioneve publike shëndetësore si organizata të regjistruara në RKS si joprofitabile;
  - 1.2 Mbështetja e veçantë financiare përmes bashkëfinancimit me institucionet shëndetësore të edukimit të vazhdueshëm profesional të anëtarëve të OMK-së përmes procedurës së veçantë rekrutuese, brenda lëmisë që posedon licencën e punës.
2. Subvencionimet e veçanta të përcaktuara sipas paragrafit 1 të këtij neni, në kuptim të kësaj rregulloreje do të trajtohen si programe të përkrahjes së veçantë të edukimit të vazhdueshëm profesional, dhe të njëjtat do të përkrahen nga buxheti i OMK-së dhe përkrahjes përmes projekteve të veçanta që mund të jenë të implementuara nga OMK-ja dhe të përkrahura nga donatorët.

### **Neni 20**

#### **Subvencionimi konkurrues i aktiveve të veçanta**

1. Subjektet e autorizuara sipas kësaj rregulloreje, siç janë shoqatat profesionale dhe institucionet publike shëndetësore, do të përkrahen për organizime të veçanta të edukimit të vazhdueshëm

profesional, nën kushtet e përgjithshme që janë të përcaktuara me këtë rregullore dhe kushtet e veçanta që do të jenë të përfshira në aktin e konkursit publik.

2. Subvencionimi i aktiviteteve të veçanta sipas këtij kapitulli do të jenë të përkrahura me mjete financiare të OMK-së që do të jenë të projektuara në buxhetin e miratuar të OMK-së sipas vijës së veçantë buxhetore, që do të jetë e alokuar sipas dispozitave të Rregullores për Menaxhimin e Financave të OMK-së.

### **Neni 21**

#### **Projektimi i mjeteve financiare**

1. Mjetet financiare të dedikuara për aktivitetet e veçanta, edukimin e vazhdueshëm individual dhe bashkëfinancimin e programeve të specializimit do të jenë të projektuara sipas planifikimit në kuadër të përlogaritjeve të shpenzimeve të domosdoshme të përcaktuara sipas destinacionit siç është e përcaktuar me Rregulloren për Menaxhimin e Financave të OMK-së.
2. Procedimi i projektimit dhe propozimit të mjeteve financiare për subvencionet e parapara me këtë kapitull do të bëhet në pajtim me dispozitat e Rregullores për Menaxhimin e Financave të OMK-së.

### **Neni 22**

#### **Inicimi i procedurës së konkurrimit për subvencionimin e aktiviteteve të veçanta**

1. Inicimi i procedurës së konkurrimit do të bëhet nga KEVP dhe aprovohet në bazë të vendimit të cilin e nxjerrë sipas detyrës zyrtare Kryetari i OMK-së një herë brenda vitit, përmes të cilit do të aprovohet hapjen e konkursit publik për përkrahjen financiare të aktiviteteve të veçanta të EVP-së që do të jenë të organizuara nga shoqatat profesionale dhe institucionet shëndetësore.
2. Konkursi sipas paragrafit 1 të këtij neni do t'i mundësojë shoqatave profesionale dhe institucioneve shëndetësore që përmes konkurrimit në procedurë të veçantë të organizojnë aktivitete që do të kenë impakt të veçantë për edukimin e vazhdueshëm profesional.
3. Me aprovimin e hapjes së konkursit publik, Komisioni për EVP do të jetë i autorizuar që të zbatojë procedurat rekrutuese sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.

### **Neni 23**

#### **Hapja e konkursit publik për aktivitete të veçanta dhe përmbajtja e tij**

1. Konkursi publik për përkrahjen e aktiviteteve të veçanta të EVP-së do të publikohet në ueb faqen zyrtare dhe kanalet zyrtare të rrjeteve sociale të OMK-së pas miratimit të hapjes sipas nenit 27 të kësaj rregulloreje.
2. Konkursi publik do të jetë i hapur në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e publikimit të tij.
3. Konkursi publik do të ketë këtë përmbajtje:
  - 3.1 Preambulën (hyrjen) në të cilën do të përcaktohet baza juridike e hapjes së konkursit publik;
  - 3.2 Informatën për të drejtën e konkurrimit që do të përfshijë kushtet e përgjithshme si në vijim:

- 3.2.1 Aktin e regjistrimit të shoqatës me të cilin dëshkohet se shoqata është e regjistruar me status të organizatës joqeveritare sipas legjislacionit në fuqi;
- 3.2.2 Dëshmia për qëndrueshmërinë financiare;
- 3.2.3 Deklarata e funksionalitetit - e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i shoqatës dhe anëtarët e bordit drejtues të shoqatës me të cilën bëhet deklarimi i funksionalitetit të shoqatës;
- 3.2.4 Dëshmia që shoqatës nuk i është revokuar aktiviteti apo programi i EVP-së në tre (3) vitet e fundit, vërtetuar nga shërbimi profesional i Odës.
- 3.2.5 Për kërkesat e parashtruara nga institucionet shëndetësore nuk zbatohen paragrafet 3.2.1, 3.2.2 dhe 3.2.3.
- 3.3 Kushtet e veçanta si në vijim:
  - 3.3.1 Elaborati profesional/shkencor me të cilin do të përshkruhet përmbajtja e aktivitetit të EVP-së;
  - 3.3.2 Lista e ligjëruesve dhe prezantimet me dokumentacionin përcjellës të ligjëruesve duke përfshirë CV-të e ligjëruesve në event; dhe
  - 3.3.3 Dokumenti i përshkrimit të impaktit të aktivitetit nga aspekti praktik dhe multidisiplinor;
- 3.4 Udhëzimi për mënyrën e dorëzimit të dokumentacionit, duke përfshirë adresën e selisë së OMK-së, personin kontaktues dhe afatin e fundit për dorëzim të dokumentacionit të përshkruar me datë konkrete të ditës dhe orës së fundit për dorëzim.
- 4. Me rastin e publikimit të konkursit, Komisioni i EVP-së do të aprovojë formën e aplikacionit i cili do të publikohet së bashku me konkursin publik. Dokumentacioni sipas paragrafit 3 të këtij neni duhet të dorëzohet në ekzemplar fizik dhe në dokumente origjinale apo të noterizuara.

#### **Neni 24**

#### **Shqyrtimi i aplikuesve sipas konkursit publik dhe përzgjedhja e aktiviteteve për mbështetje**

1. Komisioni për EVP është organi kompetent i OMK-së që të shqyrtojë dokumentacionin e aplikuesve në konkursin publik për subvencionimin e aktiviteteve të veçanta të EVP-së.
2. Komisioni i EVP-së fillon shqyrtimin e dokumentacionit në një afat jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga mbyllja e konkursit publik dhe të gjithë procedurën e shpalljes së fituesit duhet ta përfundojë deri në tridhjetë (30) ditë nga mbyllja e konkursit publik.
3. Me rastin e shqyrtimit të dokumentacionit të aplikuesve, Komisioni i EVP-së do të përzgjedh përfituesit sipas kriterëve si në vijim:
  - 3.1 Kredibiliteti i ligjeruesve me renome ndërkombëtare;
  - 3.2 Formatin e organizimit (kombëtar, ndërkombëtar) interdisiplinor i aktivitetit;
  - 3.3 Nevoja praktike dhe deficitare e fushës profesionale/shkencore që do të trajtohet në aktivitet.
4. Komisioni i EVP-së për secilin nga kriteret e përfshira në paragrafin 3 do të poentojë aplikuesit nga 1 deri në 10 poenë maksimal.



5. Njoftimi për aplikuesit e përzgjedhur për mbështetje financiare sipas afatit të përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni, do të bëhet përmes publikimit të shpalljes në ueb faqen dhe kanalet zyrtare të rrjeteve sociale të OMK-së.
6. Aplikuesit e pakënaqur me vlerësimin e Komisionit për EVP kanë të drejtë që të parashtrojnë ankesën e tyre në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit sipas paragrafit 5 të këtij neni. Ankesa e aplikuesve i drejtohet Këshillit Drejtues të OMK-së.

## Neni 25

### Mbështetja e veçantë e profilizimeve

1. OMK-ja sipas thirrjes për shprehje të interesit do t'i drejtohet institucioneve shëndetësore përmes të cilës do të kërkohet nga institucionet që u drejtohet thirrja e tillë që të shprehin interesin duke listuar profilet e nevojshme brenda lëmvive specialitike lidhur me personelin e tyre, në mënyrë që të ofrohet mbështetja financiare e profilizimeve të veçanta të specialistëve që janë anëtar të OMK-së, pas nënshkrimit të marrëveshjes në mes OMK-së dhe Institucionit Shëndetësor.
2. Thirrja për shprehje të interesit do t'ua mundësojë institucioneve shëndetësore që në një afat prej dyzet e pesë (45) ditëve të njoftojnë OMK-në lidhur me profilet për të cilat institucionet e tilla konsiderojnë se janë të nevojshme për rekrutimin e specialistëve që ushtrojnë veprimtarinë pranë institucioneve të tyre.
3. Pas pranimit të shprehjes së interesit nga institucionet shëndetësore, Kryetari i OMK-së do t'i propozojë Këshillit Drejtues aprovimin e listës së profileve për të cilat institucionet shëndetësore kanë shprehur interesin për profilizimin e specialistëve.
4. Me aprovimin e propozimit nga paragrafi 3 i këtij Neni, do të fillojë procedura e rekrutimit për ndarje të profilizimeve. Konkursi i tillë do të hapet pasi që Këshilli Drejtues ta ketë përcaktuar numrin e specialistëve dhe profilet që do të përzgjidhen dhe shumën e mjeteve që do të përcaktohen për rekrutimin e tillë.
5. Me qëllim të aplikimit të mbështetjes financiare sipas këtij neni, Oda do të mbulojë 40% të shumës, por jo më shumë se 5.000,00€, pas arritjes së marrëveshjes sipas paragrafit 1 të këtij neni.
6. Me vendim të Këshillit Drejtues sipas paragrafit 4 të këtij neni, do të arsyetohen profilizimet e veçanta që konsiderohen si profile deficitare në lëminë mjekësore.
7. Me aprovimin e mbështetjes së veçantë të profilizimeve, Komisioni për EVP do të autorizohet që të zhvillojë procedurat konkurruese.

## Neni 26

### Hapja e konkursit për edukim të vazhdueshëm profesional dhe përmbajtja e tij

1. Konkursi publik për përkrahjen e edukimit të vazhdueshëm profesional do të publikohet në ueb faqen zyrtare dhe kanalet zyrtare të rrjeteve sociale të OMK-së dhe institucioneve gjegjëse shëndetësore, për të cilat do të hapet konkursi publik, pas miratimit të hapjes sipas nenit 25 të kësaj rregulloreje.
2. Konkursi publik do të jetë i hapur në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e publikimit të tij.
3. Konkursi publik do të ketë këtë përmbajtje:
  - 3.1 Preambulën (hyrjen) në të cilën do të përcaktohet baza juridike e hapjes së konkursit publik;
  - 3.2 Informatën për fushat e propozuara, numrin e profileve të mundshme për aprovim dhe të drejtën e konkurrimit që do të përfshijë kushtet e përgjithshme si në vijim:
    - 3.2.1 Dokumentet përcjellëse të kredencialeve profesionale siç është certifikata e specializimit dhe licenca specialistike valide. Në rast se aplikuesi e ka përfunduar shkollimin specialistik jashtë Republikës së Kosovës, do të aplikohen përshtatshmërisht dispozitat lidhur me nostrifikimin dhe barasvlerësimin e shkollimit në shtetet e huaja; dhe
    - 3.2.2 Dëshmia se aplikuesit nuk i është shqiptuar ndonjë masë disiplinore nga organet etike të OMK-së e vërtetuar nga shërbimi profesional.
    - 3.2.3 Dëshmia se aplikuesit nuk i është shqiptuar ndonjë sanksion penal lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale që ndërlikohet me ushtrimin e profesionit të mjekut, përmes dëshmisë së lëshuar nga KGJK.
  - 3.3 Kushtet e veçanta si në vijim:
    - 3.3.1 Elaborati profesional/shkencor me të cilin do të përshkruhet përmbajtja e edukimit të vazhdueshëm profesional të përzgjedhur nga aplikuesi (përfshirë edukimin e vazhdueshëm profesional të cilin e propozon në mënyrë vetanake aplikuesi); dhe
    - 3.3.2 Pëlqimi dhe arsyetimi i nevojës profesionale i institucionit shëndetësor në të cilin e ushtron veprimtarinë mjekësore aplikuesi.
    - 3.3.3 Aplikuesi me rastin e aplikimit duhet të deponojë deklaratën me shkrim përmes së cilës zotohet se do të vazhdojë angazhimin me orar të plotë pranë institucionit gjegjës së paku edhe për tre vite pas përfundimit të edukimit të vazhdueshëm;
    - 3.3.4 Në rast se aplikuesi nuk i përmbahet deklaratës nga pika paraprake, i njejti obligohet të bëjë kthimin e mjeteve financiare të ndara për edukimin e vazhdueshëm profesional në afat prej 14 ditësh nga shkëputja e kontratës;
    - 3.3.5 Edukimi i vazhdueshëm profesional duhet të jetë nga lëmia specifike specialistike që i përgjigjet fushës së specializimit të aplikuesit;
    - 3.3.6 Njohuritë e fituara nga edukimi i vazhdueshëm profesional duhet të jenë të aplikueshme në punën që e ushtron mjeku;
    - 3.3.7 Udhëzimi për mënyrën e dorëzimit të dokumentacionit, duke përfshirë adresën e selisë së OMK-së, personin kontaktues dhe afatin e fundit për dorëzim të dokumentacionit të përshkruar me datë konkrete të ditës dhe orës së fundit për dorëzim.
4. Me rastin e publikimit të konkursit, Komisioni i EVP-së do të aprovon formën e aplikacionit i cili do të publikohet së bashku me konkursin publik. Dokumentacioni sipas paragrafit 3 të këtij neni duhet të dorëzohet në ekzemplar fizik dhe në dokumente origjinale apo të noterizuara.

## Neni 27

### Shqyrtimi i aplikuesve sipas konkursit publik dhe shpallja e fituesit

1. Komisioni për EVP do të jetë organ kompetent i OMK-së që do të shqyrtojë dokumentacionin e aplikuesve në konkursin publik për subvencionimin e edukimit të vazhdueshëm individual.
2. Komisioni i EVP-së do të fillojë shqyrtimin e dokumentacionit në një afat jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga mbyllja e konkursit publik, dhe të gjithë procedurën e shpalljes së fituesit duhet ta përfundojë deri në tridhjetë (30) ditë nga mbyllja e konkursit publik.
3. Me rastin e shqyrtimit të dokumentacionit të aplikuesve, Komisioni i EVP-së do të bëjë përzgjedhjen e përfituesit sipas kriterëve në vijim:
  - 3.1 Programi i edukimit profesional sipas përshkrimit në elaboratin e dorëzuar nga aplikuesi dhe kohëzgjatja e aktivitetit;
  - 3.2 Zbatueshmëria në praktikë e njohurisë së fituar, përfshirë ekzistimin e pajisjeve, njësitë përkatëse, stafit mjekësor dhe kushteve tjera objektive të duhura për zbatim;
  - 3.3 Mundësia që njohuritë të përcillen tek personeli tjetër mjekësor.
4. Komisioni i EVP-së për secilin nga kriteret e përfshira në paragrafin 3 do të poentojë aplikuesit nga 1 deri në 10 pikë maksimale. Për secilin institucion për të cilin zhvillohet konkursi publik, Komisioni për EVP do të nxjerrë vendime të veçanta me të cilat do të shpallen përfituesit e mbështetjes financiare.
5. Aplikuesit të cilët kanë fituar më së shumti pikë do të shpallen fitues. Shpallja e fituesve bëhet brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni, përmes publikimit të shpalljes në ueb faqen dhe kanalet zyrtare të rrjeteve sociale të OMK-së.
6. Aplikuesit e pakënaqur me vlerësimin e Komisionit për EVP kanë të drejtë që të parashtrajnë ankesën e tyre në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shpalljes së fituesit sipas paragrafit 5 të këtij neni. Ankesa e aplikuesve i drejtohet Këshillit Drejtues të OMK-së.

## Neni 28

### Bashkëfinancimi i specializimeve

1. Me qëllim të përkrahjes së anëtarëve të OMK-së përmes përkrahjes në shkollimin specialistik për nevojat specifike të institucioneve shëndetësore, OMK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Bordin Qendror të Shkollimit Specialistik do të dakordohen për bashkëfinancimin e specializimeve.
2. Përmes marrëveshjes së veçantë me Ministrinë e Shëndetësisë, OMK-ja dhe Ministria e Shëndetësisë do të implementojnë bashkëfinancimin e shkollimit të pjesshëm specialistik për lëmitë që konsiderohen të nevojshme, gjegjësisht për procedurat e parapara me programin specialistik që nuk mund të mbahen në Republikën e Kosovës.
3. Për të implementuar bashkëfinancimin sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, OMK së bashku me Ministrinë e Shëndetësisë dhe në korrespondencë me institucionet shëndetësore, do të bëjnë studimin e fizibilitetit brenda institucioneve shëndetësore për nevojat konkrete në kuadër të shërbimeve shëndetësore specialistike që ofrohen në institucionin gjegjës.
4. Me rastin e zbatimit të studimit të fizibilitetit, OMK dhe Ministria e Shëndetësisë do të shfrytëzojnë të dhënat zyrtare shëndetësore për shërbimet e kërkuara dhe pamundësinë e ofrimit të shërbimeve të tilla duke marr parasysh mungesën e stafit adekuat për ofrimin e shërbimit të tillë specialistik dhe në mbështetje të programit specialistik.
5. Kryetari i OMK-së do të jetë i autorizuar që të fillojë negociimet me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Bordin Qendror për Shkollim Specialistik pranë Ministrisë, me të cilën do të lidhet marrëveshja e

bashkëfinancimit të shkollimit të pjesshëm specialistik, në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

6. Pas përfundimit të negociimit me Ministrinë e Shëndetësisë, Kryetari i OMK-së do të paraqesë propozimin e tij me dakordimet preliminare të arritura me Ministrinë e Shëndetësisë, duke prezantuar numrin dhe shumën e përlogaritur të bashkëfinancimit. Propozimi i tillë duhet të miratohet nga Këshilli Drejtues, dhe i njëjti do të përfshijë shumën e mjeteve financiare në pajtim me vijën e aprovuar buxhetore dhe shpenzimet që do të mbulohen për shkollimin specialistik që do të përkrahet.

### **Neni 29**

#### **Marrëveshja për bashkëfinancim të shkollimit specialistik**

1. Pas përfundimit të negociimit dhe miratimit të propozimit nga Këshilli Drejtues, OMK dhe Ministria e Shëndetësisë do të lidhin marrëveshjen në formë të shkruar lidhur me bashkëfinancimin e shkollimit të pjesshëm specialistik.
2. Në marrëveshjen e tillë do të përfshihen çështjet, por duke mos u kufizuar në veçorinë eventuale për implementimin konkret të bashkëfinancimit, elementet si në vijim:
  - 2.1 Identifikimin e lëmenjve specialistike për të cilat do të përfshihet bashkëfinancimi;
  - 2.2 Numri i specializantëve që do të financohen sipas marrëveshjes;
  - 2.3 Mënyrën dhe kushtet e përzgjedhjes së përfituesve të bashkëfinancimit;
  - 2.4 Detyrimet e palëve në marrëveshje lidhur me bashkëfinancimin, duke përfshirë shumën konkrete të shpenzimeve të mbuluara;
  - 2.5 Afatet kohore të ekzekutimit të detyrimeve;
  - 2.6 Mënyrën e mbikëqyrjes së zbatimit të bashkëfinancimit;
  - 2.7 Forma e kontaktit zyrtar përmes zyrtarëve të autorizuar të palëve;
  - 2.8 Mënyra e zgjidhjes së marrëveshjes së lidhur; dhe
  - 2.9 Çështjet e tjera të nevojshme për zbatimin e bashkëfinancimit.
3. Marrëveshja për bashkëfinancim lidhet për periudhën deri sa të përfundojë programi i veçantë i shkollimit specialistik i bashkëfinancimit të specializantëve që do të financohen sipas marrëveshjes.
4. Mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes për bashkëfinancim të specializimeve do ta bëjë Komisioni për Shkollim Specialistik pranë OMK-së dhe nga ana administrative dhe financiare mbikëqyrja do të bëhet nga Kryetari i OMK-së.
5. Shtojcat të cilat rrjedhin nga ky kapitull do t'i bashkëngjiten formularëve sipas aprovimit.

### **Neni 30**

#### **PUNIMET SHKENCORE**

#### **Mbështetja financiare e punimeve shkencore të botuara në revistat shkencore me impakt faktor**

1. Këshilli Drejtues i OMK emëron Komisionin për vlerësimin e Punimeve Shkencore të vitit paraprak.
2. Komisioni për Punime Shkencore mban takimet çdo fillim viti në të cilat hap konkursin dhe shqyrton aplikacionet për përkrahje financiare të punimeve shkencore.

3. Kriteret e veçanta në bazë të të cilave mbështetet Komisioni për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve të përkrahjes financiare për punime shkencore do të jenë në tri platformat kryesore si në vijim:
  1. Web of Science dhe;
  2. Scopus.
4. Përveç kriterëve të përgjithshme Komisioni mund të caktojë edhe kritere të tjera të cilat konsiderohen me rëndësi për vlerësimin e punimeve shkencore.
  1. OMK do të përzgjedh 10 (dhjetë) punimet më të mira.
  2. Shuma dhe përzgjedhja e punimeve do të përcaktohet në Konkurs publik të organizuar nga Këshilli Drejtues i OMK-së.
5. Anëtarët e OMK-së kanë të drejtë vetëm një herë në vitin kalendarik të përfitojnë mbështetje financiare.
6. Çdo pakënaqësi lidhur me vendimet e këtij Komisioni, anëtarët aplikues kanë të drejtë ta shprehin përmes mjetit të ankesës drejtuar organit të shkallës së dytë që është Këshilli Drejtues i Odës në afat prej 7 (shtatë) ditëve.
7. Pas vlerësimit të aplikacioneve, Komisioni zgjedh dhe publikon listën preliminare prej 10 (dhjetë) përfituesve me punimet më të mira shkencore. Lista preliminare u jep afat aplikuesve të cilët nuk janë përzgjedhur të dorëzojnë ankesat e tyre lidhur me vendimet e Komisionit.
8. Në rast se dorëzohen ankesat brenda afatit të paraparë me këtë shtojcë, ato shqyrtohen nga Këshilli Drejtues. Në të kundërtën, Komisioni përmes vendimit publikon listën finale me 10 (dhjetë) përfituesit e përkrahjes financiare për punime shkencore sipas të cilës ekzekutohen mjetet e destinuara sipas buxhetit të OMK.

### **Neni 31**

#### **ORGANIZIMI I AKTIVITETEVE TË EVP NGA OMK**

1. Këshilli Drejtues i OMK me qëllim të organizimit të aktiviteteve të EVP, respektivisht në cilësinë e organizatores së aktiviteteve emëron Këshillat si në vijim:

- 1.1 Këshillin Organizativ; dhe
- 1.2 Këshillin Shkencor.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë për Këshillat e lartcekur do të jenë si në vijim:

Këshilli Organizativ ka për detyrë:

- Të propozojë datat e mbajtjes së aktivitetit në fjalë;
- Të caktojë koordinatorët të cilët do të kujdesen për çështje teknike rreth mbatërvajtjes së aktivitetit;
- Të caktojë nevojat për materialin e nevojshëm rreth aktivitetit;

- Të caktojë përgjegjës in i cili do të përkujdeset për akomodimin e të ftuarëve në aktivitet; si dhe
- Çdo detyrë tjetër e cila mund të përcillet nga Këshilli Drejtues apo Këshilli Organizativ konsiderohet e nevojshme rreth procesit të aktivitetit.

Këshilli Shkencor ka për detyrë:

- Të caktojë kriteret për punime shkencore;
- Të caktojë mënyrën dhe kohën e prezantimeve;
- Të caktojë pjesën teknike rreth abstrakteve (numrit të fjalëve);
- Të propozojë emrat e ligjëruesve të ftuar;
- Të vlerësojë abstrakte të pranuar;
- Të refuzojë abstraktet që nuk përmbushin kriteret;
- Të përpilojë listën e autorëve që do të prezantojnë në kongres; dhe
- Çdo detyrë tjetër e cila mund të përcillet nga Këshilli Drejtues apo Këshilli Shkencor konsiderohet e nevojshme rreth procesit të aktivitetit.

## KAPITULLI V - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Neni 32

Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë Shtojcat I, II, III, IV dhe V.

### Neni 33 Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të saj nga Kuvendi i OMK dhe nënshkrimit nga Kryetari i OMK.

Prishtinë, 20 shkurt 2024

Kryetari i OMK-së  
Dr. Fleurat Sejdu, Mr. Sci




# ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

## KOMISIONI PËR EDUKIM TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL

FORMULARI NR. 2

<b>Data/Datum/Date</b>	
<b>Për/Za/To</b>	Komisionin për Edukim të Vazhdueshëm Profesional pranë OMK-së
<b>Nga/Od/From</b>	
<b>Kontakti/Contact/ Email adress:</b>	
<b>Lënda/Tema/Subject</b>	

<b>Nr.</b>	<b>Lënda:</b>	<b>Ligjëruesi:</b>	<b>Data:</b>
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			

## DËSHMIA E MBAJTJES SË LIGJËRATAVE

Nga: (subjekti që ka zhvilluar aktivitetin)

Për: Komisionin për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Personi kontaktues:

Vendi:

Data:

Nr.	Lënda	Ligjëruesi dhe vendi i punës	Data e mbajtjes	Nënshkrimi
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				



Logo e institucionit (nëse ka)

(Institucioni)

### VËRTETIM

Për pikët e fituara si Edukim i Vazhdueshëm Profesional mjekësor të akredituar nga Oda e Mjekëve të Kosovës në kuadër të planit vjetor dhe programit të EVP

Emri dhe mbiemri i mjekut	
Kodi i Licencës	
Nr. pro. të akreditimit të aktivitetit nga OMK	

Lënda	Pikët/ Numri i kredive	Vendi i mbajtjes	Data dhe ora
Koordinatori i institucionit	Nënshkrimi dhe vula e institucionit		Totali i pikëve



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

FORMULARI NR. 3

KOMISIONI PËR EDUKIM TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL

APLIKACIONI PËR AKREDITIM TË PIKËVE  
TË EDUKIMIT TË VAZHDUESHËM PROFESIONAL

NR. REF: \_\_\_\_/20\_\_

--	--	--

DATE:

Emri, emri i prindit dhe mbiemri		
Data dhe vendi i lindjes		
Numri personal		
Adresa		
Numri i telefonit		
Vendi dhe data e diplomimit		
Detaje mbi vendin e punës	Emri dhe adresa e institucionit shëndetësor	
	Nr. i anëtarësisë në Odë	
	Specializimi	
	Data specializimit	

Licenca numër:....., E vlefshme nga:..... deri:.....

DOKUMENTET E DORËZUARA:

<b>Dokumentacioni:</b>	
Kopja e letërnjoftimit	
Kopja e licencës së punës	
Kopjet e noterizuara të diplomave të studimeve pasdiplomike pas datës së lëshimit të licencës	
Kopjet e certifikatave të aktiviteteve pas datës së lëshimit të licencës	
Deklarata nën betim	

Vendi	Data	Nënshkrimi i parashtruesit

**DEKLARATË NËN BETIM**

Unë, \_\_\_\_\_ me numër personal \_\_\_\_\_ të lëshuar nga MPB-ja e Republikës së Kosovës, me përgjegjësi të plotë morale, civile dhe penale, DEKLAROJ NËN BETIM se dokumentet e dorëzuara janë me përmbajtje të vërtetë dhe dëshmojnë për aftësimin tim profesional.

Jam i vetëdijshëm për pasojat që deklarata e rrejshme konsiderohet vepër penale e sanksionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Deklarata jepet me qëllim të dëshmimit të dokumentacionit tim për arritjen e valorizimit të pikëve me qëllim të rilicencimit profesional.

\_\_\_\_\_  
Emri dhe mbiemri  
Nënshkrimi i parashtruesit



FORMULARI NR. 4

## ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

### KOMISIONI PËR EDUKIM TË VAZHDESHËM PROFESIONAL

### APLIKACIONI PËR AKREDITIM TË AKTIVITETEVE TË EVP-së

(KY APLIKACION DUHET TË DORËZOHET SË PAKU 15 DITË PARA MBAJTJES SË AKTIVITETIT)

Emri i ngjarjes: \_\_\_\_\_ Data e aplikimit: \_\_\_\_\_

Emërtimi i Shoqatës/Institucionit Shëndetësor: \_\_\_\_\_

Emri, E-mail /Tel. i personit kontaktues: \_\_\_\_\_

Lloji:                      Kongres/Konferencë      Kurs/Workshop (Punëtori)  
                                 Seminar/Simpozium

Tjetër (shpjego): \_\_\_\_\_

Vendi i tubimit: \_\_\_\_\_ Data e tubimit: \_\_\_\_\_

Grupi i synuar profesional: \_\_\_\_\_

Kohëzgjatja: \_\_\_\_\_ Numri maksimal i pjesëmarrësve: \_\_\_\_\_

Numri i regjistrimit të Shoqatës/Organizatës:

Vendi	Data	Nënshkrimi
-------	------	------------

Rekomandimet dhe aprovimi (emri, nënshkrimi dhe data e personit autorizues)

/Kjo pjesë plotësohet nga i autorizuari i Komisionit për EVP/

Komisioni për EVP    Akreditohet aktiviteti/programi     Po     Jo    Data: \_\_\_\_\_<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Kopja e faqes së parë të aplikacionit i dorëzohet parashtruesit pas shqyrtimit të aplikacionit nga Komisioni për EVP.

**Këshillë juridike:** Ndaj këtij akti, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të tij. Ankesa duhet parashtruar pranë Këshillit Drejtues të OMK-së.

INFORMATA SHITESË, Ju lutemi, bashkëngjitni informatat, në vijim:

- Programi i detajuar i aktivitetit (objektivat, përmbajtja, metodologjia, orari, orët e aktivitetit, testimi vlerësues i pjesëmarrësve, etj.);
- Buxheti;
- Dobia e pritur për pjesëmarrësit, qendrën/institucionin, vendin;
- Termat e referencës;
- Certifikata e regjistrimit të organizuesit;
- CV-të e ligjëruesve.

TERMAT E REFERENCËS

Prezantimi i ngjarjes:

Qëllimi i ngjarjes:

Kohëzgjatja:

Buxheti:

Kuotizimi:


PO

JO


*Nëse po atëherë specifikoni shumën me të cilën do të ngarkohen pjesëmarrësit.*

Dobia e pritur:


a) për stafin:



b) qendrën/institucionin:



c) vendin:



EMRI DHE MBIEMRI	
NUMRI I ANTARËSISË	
NUMRI PERSONAL	
NUMRI I LICENCËS	
DATA E VLEFSHMËRISË SË LICENCËS	Prej: Deri:

### I. Pjesëmarrja në Kongrese/Konferenca

<i>Kongresi/Konferenca</i>	<i>Vlerësimi në pikë (pikët maksimale)</i>		
Kongresi/Konferenca vendore	Pjesëmarrja aktive	deri	15 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	10 pikë
Kongresi/Konferenca vendore me pjesëmarrje ndërkombëtare	Pjesëmarrja aktive	deri	20 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	15 pikë
Kongresi/Konferenca ndërkombëtare	Pjesëmarrja aktive	deri	25 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	20 pikë

### II. Pjesëmarrja në kurse vendore

<i>Kurset vendore</i>	<i>Vlerësimi në pikë (pikët maksimale)</i>		
Kursi i kategorisë së I.	Pjesëmarrja aktive	deri	20 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	15 pikë
Kursi i kategorisë së II.	Pjesëmarrja aktive	deri	15 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	10 pikë
Kursi i kategorisë së III.	Pjesëmarrja aktive	deri	10 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	8 pikë

### III. Pjesëmarrja në kurse ndërkombëtare

<i>Kurset ndërkombëtare</i>	<i>Vlerësimi në pikë (pikët maksimale)</i>		
Kursi i kateg. së I.	Pjesëmarrja aktive	deri	30 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	20 pikë



Kursi i kateg. së II.	Pjesëmarrja aktive	deri	20 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	15 pikë
Kursi i kateg. së III.	Pjesëmarrja aktive	deri	12 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	10 pikë

#### IV. Edukimet e ngushta specifike

<i>Shkallët</i>	<i>Vlerësimi në pikë (pikët maksimale)</i>		
Edukimi i ngushtë specifik i shkallës së I.	Pjesëmarrja aktive	deri	25 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	20 pikë
Edukimi i ngushtë specifik i shkallës së II.	Pjesëmarrja aktive	deri	20 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	18 pikë
Edukimi i ngushtë specifik i shkallës së III.	Pjesëmarrja aktive	deri	18 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	15 pikë

#### V. Pjesëmarrja në simpoziume dhe takime pune profesionale

<i>Simpoziumet</i>	<i>Vlerësimi në pikë (pikët maksimale)</i>		
Simpoziumi/takimi vendor	Pjesëmarrja aktive	deri	9 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	7 pikë
Simpoziumi/takimi vendor me pjesëmarrje ndërkombëtare	Pjesëmarrja aktive	deri	10 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	8 pikë
Simpoziumi/takimi ndërkombëtar	Pjesëmarrja aktive	deri	15 pikë
	Pjesëmarrja pasive	deri	10 pikë

#### VI. Qëndrimet studimore me qëllim të edukimit të vazhdueshëm mjekësor (në kohëzgjatje prej një jave e deri në një vit e më tepër)

Qëndrimi studimor vendor me mentor, me përshkrim të aktiviteteve të kryera, të	Deri 10 pikë në javë, maksimum 50 pikë në një periudhë të rilencimit
--	---

nëshkruara nga mentori dhe udhëheqësi i institucionit	
<b>Qëndrimi studimor jashtë vendit me mentor,</b> me përshkrim të aktiviteteve të kryera, të nënshkruara nga mentori dhe udhëheqësi i institucionit	Deri <b>15 pikë</b> në javë, maksimum <b>60 pikë</b> në një periudhë të rilicencimit
<b>Vizitat e tipit të hapur në klinika,</b> të vërtetuara-verifikuara nga personi i autorizuar	Deri <b>1 pikë</b> për vizitë, Maksimum <b>10 pikë</b> në një periudhë të rilicencimit

## VII. Ligjëratat profesionale

Ligjëratë profesionale-shkencore nga ligjëruesit e ftuar ndërkombëtar	Pjesëmarrja aktive 4 pikë Pjesëmarrja pasive 3 pikë
Ligjëratë profesionale në tribuna publike - shëndetësore për edukim shëndetësor të popullatës	Pjesëmarrja 2 pikë
Ligjëratat profesionale në takimet e nivelit parësor, dytësor dhe tretësor	Pjesëmarrja aktive 3 pikë Pjesëmarrja pasive 2 pikë
Mbledhjet në takimet e tjera/ndryshme profesionale	Pjesëmarrja aktive deri 6 pikë Pjesëmarrja pasive deri 4 pikë
Mbledhjet vjetore të shoqatave profesionale	Pjesëmarrja aktive deri 7 pikë Pjesëmarrja pasive deri 5 pikë
Mbledhjet vjetore të shoqatave profesionale ndërkombëtare	Pjesëmarrja aktive deri 10 pikë Pjesëmarrja pasive deri 7 pikë

## VIII. Publikimet (publikimet e mëposhtme vlejnë vetëm brenda afatit të licencës së fundit)

### IX.

Publikim në revistë me recension ndërkombëtar në Webofscience, Pubmed. dhe Scopus.	Total 40 pikë. Prej tyre 10 pikë autori i parë, 10 pikë autori korrespondent, pikë autori i parë dhe 20 të tjera ndahen në mënyrë të barabartë për numrin e bashkautorëve të tjerë.
Publikim shkencor/profesional revista me indeks në platforma të tjera (si IndexMedicus, Excperta, vendore dhe të tjera).	Total 30 pikë. Prej tyre 7.5 pikë autori i parë, 7.5 pikë autori korrespondent dhe 15 të tjera ndahen në mënyrë të barabartë për numrin e bashkautorëve të tjerë.
Publikim i paindeksuar shkencor	Total 15 pikë, prej tyre 3.5 pikë autori i parë, 3.5 pikë autori korrespondent dhe 8 pikë të tjera ndahen në mënyrë të barabartë për numrin e bashkautorëve të tjerë.
Autor i abstraktit apo posterit në kongres/konferencë apo simpozium pa pjesëmarrje në tubim	4 pikë

Autor i librit shkencor	40 pikë
Recensent/Redaktor i librit shkencor	30 pikë
Kapitull i një libri shkencor	10 pikë, më së shumti 30 pikë për një periudhë të rilicencimit
Redaktor i revistës së indeksuar	Nga 5 pikë në vit. Më së shumti 30 pikë për një periudhë të rilicencimit
Kryeredaktor i revistës së indeksuar	Më së shumti 40 pikë për një periudhë të rilicencimit
Recension i punimeve shkencore në revista të indeksuara	Nga 5 pikë për recension, më së shumti 30 pikë për një periudhë të rilicencimit

**Publikimet** (publikimet e mëposhtme vlejné vetém brenda afatit të licencës së fundit)

Publikim në revistë në Web of science, dhe Scopus.	10 pikë autori i parë dhe autori korrespondent, 5 pikë për bashkautorë.
Publikim shkencor në revista të indeksuara, në platforma të tjera si: (PubMed, IndexMedicus, Excperta, Embase, vendore dhe të tjera).	5 pikë autori i parë, 5 pikë autori korrespondent dhe 2.5 për bashkautorë.
Publikim shkencor/profesional në revistë të paindeksuar	2.5 pikë autori i parë dhe autori korrespondent., dhe 1 pikë për bashkautorë.
Autor i abstraktit apo posterit në kongres/konferencë apo simpozium ndërkombëtar pa pjesëmarrje në tubim	4 pikë autori i parë dhe autori korrespondent, dhe nga 2 pikë për bashkautorë
Autor i abstraktit apo posterit në kongres/konferencë apo simpozium vendor pa pjesëmarrje në tubim	2 pikë autori i parë dhe autori korrespondent, dhe nga 1 pikë për bashkautorë
Autor i librit shkencor	40 pikë
Recensent/Redaktor i librit shkencor	30 pikë
Kapitull i një libri shkencor	10 pikë, më së shumti 30 pikë për një periudhë të rilicencimit
Redaktor i revistës së indeksuar	Nga 5 pikë në vit. Më së shumti 30 pikë për një periudhë të rilicencimit
Kryeredaktor i revistës së indeksuar	Më së shumti 40 pikë për një periudhë të rilicencimit
Recension i punimeve shkencore në revista të indeksuara	Nga 5 pikë për recension, më së shumti 30 pikë për një periudhë të rilicencimit

**X. Arritjet shkencore dhe studimet profesionale pasdiplomike**

Magjistër i shkencës	30 pikë
----------------------	---------

Doktor i shkencës	60 pikë
-------------------	---------

### XI. Paraqitja e efekteve anësore të medikamenteve

Paraqitja e efekteve anësore të medikamenteve	2 pikë për secilin efekt anësor, më së shumti 20 pikë për një periudhë të rilicencimit.
---	---

Udhëzues: Pranimi i këtyre pikëve për çdo efekt anësor të paraqitur, bëhet në bazë të raportit të Agjencionit për Produkte Medicinale të Republikës së Kosovës, i cili i dorëzon raportin Komisionit të EVP, një herë në vit.

### XI. Primarius

Primarius	33 pikë
-----------	---------

### XII. Mentorimi dhe format tjera të edukimit profesional

Udhëheqës i programit të edukimit specialistik	Më së shumti deri 20 pikë brenda një periudhe të rilicencimit
Mentorim i specializimit ose subspecializimit	5 pikë për secilin mentorim, më së shumti deri 20 pikë brenda një periudhe të rilicencimit
Mentorim i doktoratës apo magistraturës	20 pikë për secilin mentorim, më së shumti 40 pikë brenda një periudhe të rilicencimit
Mentorim i stazhit të praktikantit ose ndonjë edukimi tjetër shtesë	5 pikë për mentorim, më së shumti deri 20 pikë brenda një periudhe të rilicencimit

### FORMA TË TJERA TË EDUKIMIT TË PËRHERSHËM

Komisioni për EVP në rast të prezantimit të dokumentacionit të vërtetuar nga aplikuesi për rilicencim për aktivitete të tjera, të cilat nuk janë përfshirë në udhëzuesin për EVP, mund t'i pranojë më së shumti 10 pikë për një periudhë të rilicencimit.

### SHTOJCA III

**Caktimi i taksave administrative me rastin e akreditimit të aktiviteteve do të bëhet siç vijon më poshtë:**

1. Paraqitja e aktivitetit me kërkesë për akreditim duhet të bëhet së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së zhvillimit të aktivitetit;
2. Aktivitetet e shoqatave profesionale me status joprofitabil me kuotizime - pagesa prej 300.00 € deri në 500.00 € për procedura administrative;
  1. Kongreset - 500.00 €;
  2. Simpoziumet dhe seminarët me pjesëmarrje ndërkombëtare - 400.00 €;
  3. Konferenca vendore pa pjesëmarrje ndërkombëtare - 300.00 €;
  4. Konferenca vendore me pjesëmarrje ndërkombëtare - 400.00 €.
3. Aktivitetet e shoqatave profesionale me status joprofitabil si dhe aktivitetet e organizuara nga Institucionet Publike të Arsimit të Lartë të akredituara nga organi kompetent i MASHT pa kuotizime - falas;
4. Aktivitetet e organizuara nga kompanitë prodhuese farmaceutike si dhe kompanitë tregtare farmaceutike, shtesave ushqimore (food supliment) dhe mjeteve, aparaturave dhe pajisje mjekësore - pagesa prej 700.00 € për procedura administrative.
5. Aktivitetet e organizuara nga institucionet e arsimit të lartë të akredituara nga organi kompetent i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, subjektet biznesore që kanë veprimtarinë e regjistruar të ndërlidhur me fushën e mjekësisë me përjashtim të kompanive sipas paragrafit 4, të gjithë personat e tjerë fizik dhe juridik me kusht të jenë të licencuar për aftësim profesional - pagesa prej 600€.



**ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS**  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

**SHTOJCA IV - FLETËPRANIMI I APARATEVE NGA ORGANIZATORI, PËR EVIDENTIMIN E PREZENCËS SË PJESËMARRËSVE NË AKTIVITET**

Emri dhe mbiemri i pranuesit të aparateve			
Vendi i lindjes			
Numri personal		Shtetësia	
Adresa			
Numri i telefonit			
E-mail adresa			
Nr. Ref. i Certifikatës së akreditimit të aktivitetit			
Emërtimi i aktivitetit			

### Deklaratë

Unë, i lartshënuari me të dhënat personale, e plotësoj këtë fletëpranim me vetëdije dhe vullnet të plotë ku zotohem se pajisjet-aparatet për evidentimin e prezencës së pjesëmarrësve në aktivitetin e akredituar nga Oda e Mjekëve të Kosovës, do t'i kthejë në gjendje të rregullt apo në gjendjen në të cilën më dorëzohen nga personi i autorizuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës.

Dorëzoi: (zyrtari i autorizuar i OMK-së)

Vendi	Data	Nënshkrimi

Pranoi: (zyrtari i autorizuar i aktivitetit)

Vendi	Data	Nënshkrimi

### Kthimi i pajisjeve

### Deklaratë

Unë, i lartshënuari me të dhënat personale, e plotësoj këtë fletëdorëzim me vetëdije dhe vullnet të plotë ku zotohem se pajisjet-aparatet për evidentimin e prezencës së pjesëmarrësve në aktivitetin

e akredituar nga Oda e Mjekëve të Kosovës, do t'i kthej në gjendje të rregullt apo në gjendjen në të cilën i kam pranuar nga personi i autorizuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës.

Dorëzoi: (zyrtari i autorizuar i aktivitetit)

Vendi	Data	Nënshkrimi

Pranoi: (zyrtari i autorizuar i OMK-së)

Vendi	Data	Nënshkrimi

**Shënim:** Zyrtari i autorizuar i Odës nuk do t'i pranojë pajisjet/aparatet në rast se nuk janë në gjendje të rregullt, siç janë dorëzuar te zyrtari i autorizuar i aktivitetit.